

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)*

VICTORIA - AL

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K81531041T

NUIS/NIPT

Rruga Muhamet Gjollësja, Pallati 58, Shkalla 1, Ap 3

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692092307

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@victoria.al

E-mail

Administrator Aleksander Çavo

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/11/13

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355692092307

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-86660-11-07-2023

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Bashkia Tirane

---

Vlera e përllogaritur e prokurimit

*Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

3225000

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Blerje hapëse -prerëse hidraulike me bateri

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2023/11/20

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/11/20

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/98235/11072023

35110000-8 35112000-2

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Dokumentet Standarde të Tenderit me objekt “Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri”, Specifikimet Teknike të hartuara për këtë procedurë prokurimi, Procesverbali i argumentimit, hartur nga Autoriteti Kontraktor

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Më datë 08.11.2023 nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë është shpallur për t'u zhvilluar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri”. Pas shqyrtimit të hollësishëm të Dokumenteve të tenderit të hedhura në sistemin elektronik të APP-së nga ana e Autoritetit Kontraktor, janë konstatuar një sërë parregullsish në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, sa i përket mënyrës së përcaktimit nga ana e Autoritetit Kontraktor si dhe në hartimin e specifikimeve teknike, të cilat krijojnë parregullsi, paqartësi si dhe mosbarazi gjatë pjesëmarrjes në këtë procedurë prokurimi.

Për pasojë VICTORIA - AL sh.p.k., në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në legjislacion për prokurimin publik ka vendosur të ankimojë procedurën e prokurimit me objekt “Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri”, duke kërkuar modifikimin e specifikimeve teknike të parashikuara në këtë procedurë prokurimi.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Gjatë shqyrtimit me hollësi të Dokumenteve të tenderit të hartuara nga Autoriteti Kontrktor janë konstatuar një sërë parregullsish në hartimin e Specifikimeve Teknike, elementë thelbësorë në hartimin e dokumentacionit kualifikues nga ana e operatorëve ekonomikë në këtë këtë procedurë prokurimi, kjo në kundërshtim të hapur me sa përcaktuar në nenin nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se Qëllim i këtij ligji është: ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik? si dhe nenin 3, pika 2, ku citohet se?Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Në rsatin konkret, vihen re dhe konstatohen parregullsitë e hapura në hartimin e specifikimeve teknike si më poshtë vijon:

1. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, në emërtimin e specifikimeve teknike të hartuara për këtë procedure prokurimi është deklaruar: Specifikime teknike: për Blerje presa pneumatike, ndërkohë që në rastin konkret emërtimi i vetë procedurës së prokurimit është Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri.

Në rastin konkret lind menjëherë pyetja nëse nga Autoriteti Kontraktor kërkohet blerja e një Prese pneumatike apo e një Hapëse-prerëse hidraulike me bateri. Theksojmë se kemi të bëjmë me dy produkte të ndryshme, që nuk përkojnë me njëra tjetrën, duke krijuar qartazi konfuzion për operatorët ekonomikë të interesuar që në momentin fillestar në leximin e specifikimeve teknike, thelbësore në ofrimin e saktë të produktit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në shpalljen e procedurës së prokurimit, në kundërshtim me nenin 36, pika 2,3 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020

“Për prokurimin publik”, ku citohet se “Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën?”.

Mbështetur në sa mësipër kërkohet modifikimi i Specifikimeve teknike të hartuara në këtë procedurë prokurimi, duke specifikuar në mënyrë të saktë emërtimin e tyre për të mundësuar paraqitjen e një oferte të rregullt nga ana e operatorëve ekonomikë.

2. Në vijim në formularin e Specifikimeve teknike, nga Autoriteti Kontraktor nuk është përcaktuar nëse pajisjet e kërkuara për prokurim në këtë procedure prokurimi duhet të jenë pajisje të reja apo do të pranohen pajisje të përdorura.

Në rastin konkret mungesa e këtij përcaktimi në formularin e Specifikimeve teknike rezulton si mangësi thelbësore, kjo pasi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në përcaktimin e cmimit të saktë të Ofertës Ekonomike, nga ana e Operatorëve Ekonomikë në paraqitjen e saj pranë Autoritetit Kontraktor. Qartësojmë se mungesa e këtij specifikimi, do të krijonte një situatë ku do të verifikohesh një trajtim i pabarabartë dhe diskriminues midis operatorëve ekonomikë ofertues. Kjo do të ndikonte në mënyrë të drejtëpërdrejtë në paraqitjen e një oferte të drejtë dhe reale nga ana e operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në klasifikimin apo skualifikimin e operatorëve ekonomikë nga ana e autoritetit kontraktor, duke krijuar një situatë konfuze dhe të paqartë në gjykimin e ofertave të paraqitura. Ky fakt gjen një mbështetje të fortë në legjislacionin për prokurimin publik.

Në nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik?”

Në nenin 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit dhe konkretisht tek specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet dhe konkretisht?Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Po në VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, të ndryshuar, neni 40, pika 2 citohet se: “Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”

Mbështetur në sa mësipër, kërkohet që nga ana e Autoritetit Kontraktor të bëhen modifikimet përkatëse të specifikimeve teknike ku të përcaktohet në mënyrë të qartë cilësia e produktit të kërkuar, në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore.

3. Po gjatë verifikimit të specifikimeve teknike konstatohet se kërkohet blerje e pajisjes me bateri. Sqarojmë se ky aksesor është shumë i rëndësishëm dhe thelbësor në paraqitjen e pajisjes së kërkuar pasi pa të pajisja nuk mund të vihet në punë dhe është e papërdorshme.

Konkretisht në formularin e Specifikimeve deklarohet si më poshtë vijon:

- a) Hapëse-prerëse hidraulike:  
Dimensione: Preferohet jo më shumë se 700\*300\*300
- b) Bateria:  
Dimensionet e baterise jo me shume se 200\*110\*110

Fillimisht, përcaktimi nga ana e Autoritetit kontraktor i termit “preferohet” është diskriminues si dhe ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në pjesëmarrjen dhe në klasifikimin apo skualifikimin e operatorëve ekonomikë nga ana e autoritetit kontraktor, duke krijuar një situatë konfuzë dhe të paqartë në gjykimin e ofertave të paraqitura., mbështetur në parimet ligjore bazë të parashikuara të LPP-së.

Përcaktimet e mësipërme janë të paqarta pasi nuk kanë të përcaktuar elementin bazë të njesise matese përkatëse (mm, cm, m?) si për pajisjen hidraulike, ashtu edhe për baterinë me të cilën do të pajiset kjo pajisje. Në rastin konkret është lënë në hamendësim dhe interpretim të operatorëve ekonomikë dimensionet e pajisjes dhe baterisë. Kjo sjell në mënyrë të drejtëpërdrejtë edhe një interpretim autoritar nga vetë autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave ekonomike të cilat do të paraqiten në këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu dimensionet e Hapëse-prerëse hidraulike si dhe të baterisë, krijojnë paqartësi të mëtejshme në paraqitjen e saktë të produktit të kërkuar kjo pasi në asnjë nga dimensionet e përcaktuara nuk është qartësuar nëse dimensionet e baterisë janë të perfshira apo jo në dimensionet e Pajisjes Hapëse – Prerëse Hidraulike me bateri. Duhet sqaruar se ka modele pajisjesh hapëse-prerëse të cilat e kanë të vendosur baterinë në pjesën fundore të saj, ndërkohë, ka gjithashtu modele të kësaj pajisje të cilat e kanë baterinë në pjesën e sipërme të saj. Sa më sipër, vendosja e baterisë ndikon drejtpërdrejtë në përcaktimin e përmasave totale të pajisjes, të cilat duheshin qartësuar nga Autoriteti Kontraktor në momentin e parashikimit të dimensioneve. Vihet re se në hartimin e specifikimeve teknike autoriteti kontraktor, nuk ka vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë asnjë foto ilustruese në lidhje me modelin bazë të pajisjes Hapëse-prerëse hidraulike me bateri.

Nëse Autoriteti Kontraktor në kërkesat e tij ka përcaktuar paraprakisht strukturën e kësaj pajisje (kjo duke marrë parasysh edhe vetë faktin e deklaruar mësipër në lidhje me mënyrën e ndryshme të vendosjes të baterisë, si pjesë e detyrueshme me të cilën duhet shoqëruar pajisja prerëse hidraulike) ky fakt do të kufizonte haptazi konkurrencën e lire ndërmjet operatorëve ekonomikë pasi qartazi do të orientonte drejt një prodhuesi/operatori të caktuar si dhe nuk do të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik?”, ndërkohë që në nenin 3 (Parimet ligjore) citohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë se: “Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij

ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar?”

Duhet theksuar se paqartësia në hartimin e këtyre specifikimeve bazë, ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në paraqitjen e një oferte të rregullt, transparente dhe proporcionale nga ana e operatorëve ekonomikë, duke krijuar në këtë mënyrë ngushtim në mënyrë artificiale të konkurrencës midis operatorëve ekonomikë në shkelje haptazi të parimeve bazë të përcaktuara në nenin 3 të LPP.

Ky fakt bie ndesh gjithashtu me sa cituar në nenin 36 (Specifikimet Teknike) të LPP-së i cili kërkon në mënyrë të drejtëpërdrejtë që specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Mbështetur në sa mësipër, kërkohet që nga ana e Autoritetit Kontraktor të bëhen modifikimet përkatëse të specifikimeve teknike ku të përcaktohet në mënyrë të qartë dimensionet e pajisjes hapëse - prerëse si dhe të baterisë, në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore.

4. Po në vazhdim të specifikimeve vihet re se nga Autoriteti Kontraktor është parashikuar:

Hapëse-prerëse hidraulike:

Pesha jo më shumë se 14 kg.

E pajisur me aksesorë:

Bateria të jetë jo më shumë se 1.8 kg

Sërish ky përcaktim hartuar nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike është i paqartë dhe krijon konfuzion tek operatorët ekonomikë në momentin e formulimit të ofertës përfundimtare.

Mbështetur në sa mësipër nuk arrihet të konfirmohet nëse pesha totale e pajisjes të kërkuar duhet të jete jo më shumë se 15.8 kg.

Gjithashtu përcaktime të tilla në specifikimet teknike si:

Distanca e shpërndarjes dhe Distanca e shpërndarjes së forcës janë të paqarta dhe jo të kuptueshme për operatorët ekonomikë, të cilët kanë interes që të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi. Nga ana tjetër përcaktime jo të sakta dhe të qarta të specifikimeve teknike ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në klasifikimin apo skualifikimin e operatorëve ekonomikë nga ana e autoritetit kontraktor, duke krijuar një situatë konfuzive dhe të paqartë në gjykimin e ofertave të paraqitura, Ky fakt gjen një mbështetje të fortë në legjislacionin për prokurimin publik.

Përcaktime të tilla si: Hapje e prerjes maximum 200 mm, pra duke e kufizuar hapjen e pajisjes mendojmë se nuk qëndron dhe është e gabuar pasi kufizon artificialisht ofertimin e pajisjeve të cilat kanë hapje më të madhe dhe janë më efikase gjatë përdorimit, pasi hapja lidhet me funksionalitetin e pajisjes. Sa më sipër, nuk duhet të kërkohej maximum i Hapjes por duhet të kërkohej minimumi i hapjes.

Kurse përcaktimet konkrete të bëra nga Autoriteti Kontraktor si: 1350/137.7kn/t, pra pa cilësuar në asnjë moment termat thelbësorë min-max ose pa cilësuar psh: nga 30 kN deri në 1350 kN, kufizojnë në mënyrë reale konkurrencën e lirë në këtë procedurë prokurimi, duke minimizuar mundësinë e pjesëmarrjes së Operatorëve Ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, në kundërshtim të hapur me nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ?ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik?”, ndërkohë që në nenin 3 (Parimet ligjore) citohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë se:”?Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin

fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar?”

Po në VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, të ndryshuar, neni 40, pika 2 citohet se: “Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

Mbështetur në përcaktimet e mësipërme të bëra nga Autoriteti Kontraktor, konstatohet se jo vetëm që nuk është bërë një përshkrim i saktë i këtyre elementëve, por edhe bazikë në formulimin e ofertës nga operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë, por këto elementë rezultojnë të paqartë, evazivë si dhe të pakuptueshëm, duke ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në limitimin e konkurrencës si dhe në një trajtim diskriminues dhe të pabarabartë, në momentin e thelbësor të hartimit të ofertës ekonomike nga ana e këtyre të fundit.

Mbështetur në sa mësipër, kërkohet që nga ana e Autoritetit Kontraktor të bëhen modifiket përkatëse të specifikimeve teknike ku të përcaktohet në mënyrë të qartë pasha totale e pajisjes së kërkuar, të jepen në mënyrë të hollësishme sqarimet përkatëse në lidhje me distancën e shpërndarjes dhe distancën e shpërndarjes së forces si dhe të përcaktohen nga autoriteti kontraktor temat min-max, në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore.

5. Në hartimin e specifikimeve teknike Autoriteti Kontraktor, në Grafikon dhe afatet e lëvrimit ka parashikuar: Malli duhet të lëvrohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e lidhjes së kontratës.

Pajisjet hapëse prerëse me bateri që prokurohen, janë pajisje speciale profesionale të cilat duhet të perdoren vetëm nga shërbime të specializuara.

Sqarojmë se këto pajisje nuk janë pajisje të gatshme, por prodhohen me porosi të vecantë jashtë Shqipërisë, sipas kërkesave/specifikimeve të klientit përkatës. Por elementi më i rëndësishëm është se çdo prodhues paraprakisht kërkon informacion të detajuar për identifikimin e përdoruesit fundor të kësaj pajisje, për të konfirmuar dhe më tej nisur prodhimin e pajisjeve prerëse hidraulike. Secila pajisje e re që do të prodhohet është e pajisur me një numër serial identifikues nga vetë fabrika për të siguruar mundësinë e gjurmimit të saj në rastet më ekstreme të një vjedhje apo përdorimi të saj nga persona të paautorizuar.

Mbështetur në sa më sipër vihet re se afati i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor rezulton i pamjaftueshëm kjo për vetë faktet se:

a) Pajisjet do të prodhohen jashtë vendit tone, pas një procedure specifike porosie nga kërkuesi dhe përfundimit të fazës së detyrueshme të marrjes së informacionit të deklaruar më sipër nga ana e fabrikës prodhuese.

b) Në përfundim të kësaj faze, duhet marrë parasysh koha e prodhimit të tyre e cila do të variojë mbështetur në sasinë e pajisjeve të kërkuara si dhe specifikimeve teknike të kërkuara nga vetë Autoriteti Kontraktor të cilët janë të nevojshëm në prodhimin e tyre

c) Gjithashtu në përfundim të prodhimit të tyre duhen konsideruar element të tjerë rëndësishëm që ndikojnë drejtëpërdrejtë në afatet e lëvrimit sic janë: procedurat e transportit deri në Shqipëri, zhdoganimit të këtyre pajisjeve si dhe elementë të tjerë të paparashikuar që mund të lindin deri në momentin përfundimtar të dorëzimit dhe që kërkojnë një kohë të caktuar.

Mbështetur në sa deklaruar mësipër, përcaktimi i afatit të lëvrimit prej 15 ditësh (një afat tejet i limituar dhe tërësisht i pamjaftueshëm), nga ana e Autoritetit Kontraktor shton dyshimet se këto pajisje mund të jenë tashmë në Shqipëri, të gatshme për dorëzim në këtë procedure prokurimi.

Në nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e



operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit public?

Po në nenin 36 të LPP-së (Specifikimet Teknike) citohet shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Përcaktimi i këtij afati të shkurtër në ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke limituar në mënyrë artificiale numrit e shoqërive që mund të paraqesin një ofertë në këtë procedure prokurimi si krijon një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues në lidhje me operatorë të ndryshëm ekonomikë. Për pasojë theksojmë se afatet e parashikuara nga Autoriteti Kontraktor bien ndesh me parimet bazë të parashikuara në ligjin 2 të prokurimit publik?”

Mbështetur në sa mësipër kërkohet modifikimi i Specifikimeve Teknike, duke parashikuar në Grafikon dhe Afatet e Lëvrimit një kohë minimale prej 30 ditë në lëvrimin e mallrave të parashikuara nga Autoriteti Kontraktor në këtë procedurë prokurimi.

## 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

---

## 6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

---

## 7. Lista e informacionit konfidencial:

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.* □

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

info@victoria.al

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Aleksander Çavo